



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 633, Datë 26.06.2019

“Mbi miratimin e Udhëzuesit “Mbi dëmet që shkaktohen dhe veprimet që ndërmerren kur shkelen dispozitat e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.06.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi miratimin e Udhëzuesit “Mbi dëmet që shkaktohen dhe veprimet që ndërmerren kur shkelen dispozitat e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar”

Baza Ligjore: Nenet 24, shkronja dh) dhe neni 65 të Ligjit 9121/2003 ‘Për Mbrojtjen e Konkurrencës’, i ndryshuar;

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE :

1. Udhëzuesi është përshtatur duke përfaruar Direktivën 2014/104/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 nëntor 2014 “Mbi disa rregulla që rregullojnë veprimet për dëmet e ligjit kombëtar për shkelje të dispozitave të ligjit të konkurrencës të Shteteve Anëtare dhe të Bashkimit Evropian” (32014L0104/ OJ L 349,5.12.2014) - (Directive 2014/104/EU of the European Parliament and of the Council of 26 November 2014 “On certain rules governing actions for damages

under national law for infringements of the competition law provisions of the Member States and of the European Union”).

2. Udhëzuesi përcakton rregullat që nxisin konkurrencën e lirë dhe efektive në treg dhe heqjen e pengesave për funksionimin e duhur të saj, duke parashikuar dispozita lidhur me procedurat që zbatohen për të siguruar mbrojtje për të gjithë ata që kanë pësuar një dëm nga shkelja e rregullave të konkurrencës.
3. Çdo person fizik ose juridik që ka pësuar dëmin e shkaktuar nga një shkelje e dispozitave të ligjit të konkurrencës ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë kompensimin për atë dëm.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja dh) dhe 65 të Ligjit 9121/2003 ‘Për Mbrojtjen e Konkurrencës’, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e Udhëzuesit “Mbi dëmet që shkaktohen dhe veprimet që ndërmerren kur shkelen dispozitat e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS